

VENDIM
Nr.684, datë 5.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.627, DATË 31.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011-2012, të jenë 9430, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 8650; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuotat për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 400; |
| d) Kuota për personat që nuk shikojnë | 20; |
| e) Kuota për romët/ballkano-egjiptianë | 20; |
| f) Kuota për të përndjekurit politikë | 100.”. |

2. Në fund të tabelës 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet programi i studimit sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha